



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 januar 2012  
Nr. ref.: RK185/11

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin nr. KI94/11**

Parashtruesi

**Lumnije Krasniqi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Komisionit të Kërkesave Banesore  
dhe Pronësore HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

**Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruese e kërkesës është Lumnije Krasniqi, rr. Hasan Remniku, Komuna e Prishtinës.

### **Vendimi i kontestuar**

2. Kontestohet Vendimi i Komisionit të Kërkesave Banesore dhe Pronësore (në tekstin e mëtejme: KKBP) HPCC/D/144/2004/C, i datës 27 gusht 2004, me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës që t'i lejohet posedimi i patundshmërisë e cila gjendet në „Bregu i Diellit II“.

### **Çështja e lëndës**

3. Parashtruesja e kërkesës konteston Vendimin HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, pa cekur nen konkret të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por pretendon si në vazhdim: *„Se ka vërtetim nga Komuna dhe bashkësia lokale se është banor i banesës në fjalë që nga viti 1999 deri në 30 mars 2007, se në cilindo vend tjetër dikush që është shtetas i atij vendi ka përparësi që pas 3 vitesh, apo më shumë, t'i jepet banesa me tapi, në përputhje me ligjin çka është më lehtë dhe ekonomikisht më e drejtë për popullin e tij...“*

### **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 paragrafi 2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

### **Procedura në Gjykatë**

5. Më 20 janar 2011, parashtruesja e kërkesës nëpërmjet postës ka paraqitur një pjesë të dokumentacionit si kërkesë për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme : Gjykata).
6. Më 21 janar 2011, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar parashtruesen e kërkesës përmes një njoftimi se çfarë duhet të përmbajë një kërkesë, në mënyrë që të konsiderohet si kërkesë para Gjykatës Kushtetuese, dhe ka regjistruar lëndën si të përkohshme.
7. Më 11 korrik 2011, parashtruesja e kërkesës ka plotësuar kërkesën e vet me dokumentacionin e nevojshëm dhe kërkesa është regjistruar në e evidencën e Gjykatës KI.
8. Më 21 korrik 2011, parashtruesja e kërkesës në adresimin e saj të tretë Gjykatës, ka kërkuar që në procedurat në Gjykatë t'i mbrohet identiteti me arsyetimin;

*„Se familja e saj ka armiq të trefishtë.“*

*„Se familjen e sajna gjenerata në gjeneratë e përcjellin agjentët serb, sepse janë patriotë dhe luftëtarë.“*

*„Se dëshiron që të drejtat e saj të realizohen në emër të Kosovës.“*

9. Më 26 korrik 2011, Gjykata Kushtetuese e ka njoftuar parashtruesen e kërkesës dhe Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), e cila është pasardhëse ligjore e KKBP, së kanë filluar procedurat e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimeve për lëndën Nr. KI-94-11.

10. Më 5 gusht 2011, AKP në përgjigjen e vet e ka njoftuar detalisht Gjykatën për procedurën lidhur me Vendimin HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, dhe njëkohësisht dorëzoi edhe kopjen e vendimit dhe përgjigjeve për palën e cila kërkon rishqyrtim.
11. Më 21 nëntor 2011, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Prof. dr Ivan Čukalović dhe Prof. dr. Gjyljeta Mushkolaj, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë të refuzojë kërkesën si të papranueshme. Njëkohësisht, Gjykata vlerësoi se kërkesa për mbrojtjen e identitetit është e pabazuar.

### **Përmbledhja e fakteve**

12. Parashtruesja e kërkesës gjatë kohës së luftës ka ikur nga vendi, me përfundimin e luftës është kthyer në Kosovë dhe pasi që nuk kishte kurrfarë strehimi KFOR-i i vendosi në një objekt në lagjen Bregu i Diellit II, „*pasiqë ish in gjendur nën qiellin e hapur*“.
13. Më 29 gusht 2001, KKBP ka pranuar kërkesën me nr. DS001936 të parashtruar nga M.K. i autorizuar nga Z.P., përmes të cilës kërkonte kthimin në posedim të banesës në lagjen Bregu i Diellit II. Si palë kundërshtare në këtë rast ishte F.K., bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës (në tekstin e mëtejme: F.K.).
14. KKBP pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar edhe të njëjës edhe të palës tjetër në kërkesën nr. DS001936, me Vendimin HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, vendosi që t'i kthejë Z.P. të drejtën e posedimit të banesës në fjalë.
15. Vendimi HPCC/D/144/2004/C, i datës 27 gusht 2004, i është dorëzuar banorit të atëhershëm të patundshmërisë në fjalë, zotëriut F.K., më 13 tetor 2005.
16. Më 19 dhjetor 2005, KKBP ka pranuar kërkesën për rishqyrtimin e Vendimit KKBP/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, paraqitur nga F.K.
17. Kërkesa për rishqyrtim është refuzuar nga KKBP, ngase nuk është paraqitur në afatin kohor prej 30 ditësh të paraparë me ligj, siç edhe parashihet në nenin 14.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.
18. Njëkohësisht, pala e cila ka kërkuar rishqyrtimin, F.K., nuk ka sjellë as edhe një dëshmi të re që nuk ishte shqyrtuar më parë, gjegjësisht asnjë dëshmi që do të dëshmonte çfarëdo të drejte të F.K. ndaj banesës në fjalë.
19. Njoftimi zyrtar për refuzimin e kërkesës për rishqyrtimin e Vendimit HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, i është dorëzuar F.K.
20. Pas fuqizimit të Vendimit HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, dhe kërkesës së P.Z. si palë e suksesshme në këtë kontest që t'i kthehet banesa në fjalë, AKP më 14 shkurt 2006 ka zhvendosur nga banesa familjen e parashtruesit të kërkesës dhe më 15 shkurt 2006 i ka dorëzuar në posedim palës së suksesshme në kontest, z. Z.P., me çka edhe u përfundua rasti në AKP.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

21. Parashtruesja e kërkesës konteston Vendimin HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, pa cekur nenin konkret të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por nga Gjykata Kushtetuese kërkon:

„Që shteti t'i ndaj asaj banesën e përmendur në kërkesën e saj me tapi dhe me çmim të arsyeshëm dhe pagesë afatgjate sipas Ligjit i cili mbështet ekonominë që kemi. Çmimi të jetë i caktuar sipas vjetërsisë së banesës dhe ekonomisë që i takon këtij popull të përvuajtur prej padrejtësive që ka, dhe i cili ka vuajtur para dhe gjatë luftës, si edhe në ditët e sotme kur armiku ka përparësi në Kosovën e lirë...“.

#### Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.
23. Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata Kushtetuese konstaton se parashtruesja e kërkesës ankohet në Vendimin HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, i cili i është dorëzuar më 13 gusht 2005. Kjo do të thotë se kërkesa ka të bëjë me ngjarjet para 15 qershorit 2008, gjegjësisht datës kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në bazë të kësaj, kërkesa është paraqitur jashtë afatit, andaj nuk është *“ratione temporis”* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit (shih *mutatis mutandis Jasiūnienė kundër Lituanisë, kërkesa nr.. 41510/98, aktgjykimi i GJEDNJ i datës 6 mars dhe 6 qershor 2003*).
24. Nga kjo rrjedhë se kërkesa duhet të hidhet poshtë në bazë të rregullit 36 (3h) të Rregullore së punës i cili parasheh: „Kërkesa mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur: h) kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.“


#### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhje me nenin 113.7 paragrafi 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (3h) të Rregullore së punës të 25 nëntorit 2011, njëzëri


#### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyq ari rapor ues

  
Dr. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

  
Prof. Dr. Enver Hasani